

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikaflex®-111 Stick & Seal

NGJITËS + IZOLUES FLEKSIBËL

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikaflex®-111 Stick & Seal është ngjitës dhe izolues me 1 përbërës, për shumë përdorime me një profil shumë të gjerë ngjitjeje dhe izolimi i cili ngjit dhe izolon shumicën e nënshtresave të zakonshme të ndërtimit. Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.

PËRDORIMET

Një ngjitës për ngjitjen e shumicës së komponentëve dhe materialeve të ndërtimit si:

- Beton
- Mure
- Shumica e gurëve
- Qeramikat
- Druri
- Metalet
- Qelqi
- Plastikati si PVC, PA, PET dhe EPS/XPS

Një izolues për izolimin e fugave vertikale dhe horizontale.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ngjitet mirë mbi shumë lloje nënshtresash pa trajtim paraprak të sipërfaqes
- Ngjitet mbi beton të lagësht
- Kompatibilitet me shumicën e nënshtresave, EPS/XPS dhe banera reklamash
- Kompatibilitet me shumicën e nënshtresave prej bitumi
- Rezistencë e mirë mekanike dhe rezistencë ndaj kushteve të motit
- Ngjitës-izolues me markë CE

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtuueshmëri me LEED v4 EQc 2: Materiale me çlirime të ulëta
- Klasifikimi GEV-EMICODE EC 1PLUS për çlirimet VOC
- Klasifikimi RTS M1 për çlirimet VOC të materialeve të ndërtimit
- Kategoria A+ sipas rregullores franceze për çlirimet VOC

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 15651-1 - Izolues për përdorim jostrukturor në fuga dhe ndërtesa - Elemente fasadash: Kategoria F EXTINT CC 20HM

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Polimere terminale silani
Ambalazhi	Tubetë 290 ml, 12 copë/kuti
Ngjyra	E bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.

Fleta e të dhënave të produktit

Sikaflex®-111 Stick & Seal
Qershor 2020, Botimi 06.01
02051302000000053

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~36 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~1,5 N/mm ²	(ISO 37)
Moduli i shformimit elastik	~0,65 N/mm ² në 60% zgjatim (23 °C)	(ISO 8339)
Zgjatimi deri në thyerje	~250 %	(ISO 37)
Risjellja elastike	~75 %	(ISO 7389)
Rezistenca ndaj përhapjes së grisjes	~4,5 N/mm	(ISO 34)
Temperatura e funksionimit	-50 °C min. / +80 °C max.	
Projektimi i fugës	<p>Gjerësia e fugës duhet të projektohet për t' u përshtatur me aftësinë e izoluesit për lëvizje. Gjerësia e fugës duhet të jetë ≥ 6 mm dhe ≤ 20 mm. Duhet të ruhet raporti 2:1 i gjerësisë me thellësinë. Fugat me gjerësi ≤ 10 mm janë për kontrollin e plasaritjeve, kështu që nuk janë fuga lëvizjeje. Për fuga më të mëdha, kontaktoni shërbimin teknik të Sika-s për informacione shtesë.</p>	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Rendimenti	Ngjitje		
	Rendimenti 1 tubetë (290 ml) ~100 pika ~15 m kordon	Përmasat Diametër = 30 mm Trashësi = 4 mm Diametri i fishekut = 5 mm (~20 ml për metër linear)	
Material mbështetjeje	Izolim		
	Gjerësi fuge mm	Thellësi fuge mm	Gjatësi fuge m për tubetë 290 ml
	10	10	2,9
	15	12	1,6
	20	17	0,9
Material mbështetjeje	Përdorni kordona prej shkume polietileni		
Rrjedha e varjes	0 mm (profil 20 mm, 23 °C)		(ISO 7390)
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max.		
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +40 °C max., min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës		
Ritmi i maturimit	~3 mm/24 orë (23 °C / 50 % lagështi relative)	Sika Corporate Quality Procedure (CQP 049-2)	
Koha e krijimit të kores	~35 min (23 °C / 50 % lagështi relative)		(CQP 019-1)

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si pislleqe, vaj, graso, kore çimentoje (qumësht), adezivë të vjetër dhe veshje të

vjetra boje të cilat do të ndikojnë në ngjitjen e ngjitësit/ izoluesit. Nënshtresa duhet të ketë rezistencë të mjaftueshme për të përballuar sforcimet e ndryshme të shkaktuara nga lëvizja e izoluesit. Mund të përdoren teknika si fërkimi me furçë teli, smerilizim, kruarje ose mjete të tjera të përshtatshme mekanike. Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të

hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të aktivizuesit, prajmerit apo ngjitësit/izoluesit.

Sikaflex®-111 Stick & Seal ngjitet pa prajmer dhe/ose aktivizues. Megjithatë, për një ngjitje të shkëlqyer duhet të ndiqen procedurat e mëposhtme të lyerjes me prajmer dhe/ose trajtimit paraprak për qëndrueshmërinë e fugës dhe aplikimet kritike me performancë të lartë:

Nënshtresat joporoze

Alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i galvanizuar, metalet e lyera me bojë në formë pluhuri, pllakat me glazurë ose PVC-ja: smerilizoni sipërfaqen me letër abrazive. Pastroni dhe trajtoni paraprakisht me Sika® Aktivator-205 të aplikuar me një copë të pastër. Përpara izolimit / ngjitjes, lini kohë pritjeje > 15 minuta (< 6 orë).

Metalet e tjera si bakri, tunxhi dhe titanium-zinku: duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht me Sika® Cleaner P ose Sika® Aktivator-205 të aplikuar me një copë të pastër. Pas një kohe pritjeje prej > 15 minutash (< 6 orë) aplikoni Sika® Primer-3 N me furçë. Lini kohë shtesë pritjeje > 30 minuta (< 8 orë) përpara ngjitjes / izolimit.

Nënshtresat poroze

Betoni, aerobetoni dhe suvatë me bazë çimentoje, llaçet dhe tullat: duhet të lyhen me prajmerin Sika® Primer-3 N të aplikuar me furçë. Përpara izolimit / ngjitjes, lini kohë pritjeje > 30 minuta (< 8 orë). Për më tepër këshilla dhe udhëzime të detajuara kontaktoni me shërbimin teknik. Shënim: Prajmerat përforcojnë ndërkapjen dhe nuk janë alternativa për përmirësimin e përgatitjes/pastrimit të dobët të sipërfaqeve të fugave. Prajmerat përmirësojnë gjithashtu performancën afatgjatë të ndërkapjes së fugës së izoluar.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Procedura e ngjitjes

Pas përgatitjes së nevojshme të nënshtresës, përgatisni fundin e tubetës përpara ose pasi ta keni vendosur në pistoletë dhe vidhosni majën. Aplikoni në formë kordonit, shiritit ose pikash me distancë disa centimetra. Ushtroni presionin e dorës vetëm për të fiksuar në pozicion elementët që do të ngjiten përpara kohës së krijimit të kores së ngjitësit. Elementët e pozicionuar gabim mund të shkëputen me lehtësi dhe të ripozicionohen gjatë minutave të para pas aplikimit. Nëse nevojitet përdorni përkohësisht shirit adeziv, pyka ose suporte për të mbajtur të bashkuara elementet e montuara gjatë kohës fillestare të tharjes. Ngjitësi i freskët dhe i patharë që ngelet mbi sipërfaqe duhet të hiqet menjëherë. Rezistenca përfundimtare arrihet pas tharjes së plotë të Sikaflex®-111 Stick & Seal, p.sh. pas 24 deri 48 orësh në +23°C, në varësi të kushteve të mjedisit dhe trashësisë së ngjitësit.

Procedura e izolimit

Maskimi

Rekomandohet përdorimi i shiritit maskues aty ku kërkohen vija të drejta dhe të sakta fugash. Hiqni shiritin brenda kohës së krijimit të kores pasi të keni mbaruar.

Mbushja e fugës me kordon

Pas përgatitjes së kërkuar të nënshtresës, vendosni kordonin në thellësinë e kërkuar.

Lyerja me prajmer

Gjatë përgatitjes së nënshtresës rekomandohet lyerja me prajmer e sipërfaqes së fugës. Shmangni aplikimin e tepruar të prajmerit që të mos grumbullohet prajmer në bazën e fugës.

Aplikimi

Përgatisni fundin e tubetës përpara ose pasi ta keni vendosur në pistoletë dhe pastaj vidhosni majën. Nxirrni Sikaflex®-111 Stick & Seal brenda fugës duke u siguruar se është në kontakt të plotë me anët e fugës dhe se është shmangur bllokimi i ajrit.

Finirimi

Menjëherë pas aplikimit, izoluesi duhet të përpunohet përkundrejt anëve të fugës për të siguruar ndërkapje të mjaftueshme dhe nivelim.

Përdorni një produkt kompatibël përpunimi (p.sh. Sika® Tooling Agent N) për të niveluar sipërfaqen e fugës. Mos përdorni produkte përpunimi që përmbajnë tretës.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208. Pas tharjes, materiali i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

Për pastrimin e lëkurës përdorni Sika® Cleaning Wipes-100.

DOKUMENTA SHITESË

- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin & ngjitjen

KUFIZIME

- Për punueshmëri të mirë, temperatura e ngjitësit duhet të jetë +20°C.
- Nuk rekomandohet aplikimi gjatë ndryshimeve të mëdha të temperaturës (lëvizje gjatë tharjes).
- Përpara ngjitjes ose izolimit, kontrolloni ndërkapjen dhe kompatibilitetin me bojërat ose veshjet duke kryer testime paraprake.
- Sikaflex®-111 Stick & Seal mund të lyhet me shumicën e sistemeve të zakonshme të veshjeve dhe bojërave me bazë uji. Megjithatë, duhet të kryhen testime paraprake për të siguruar kompatibilitetin e bojërave. Përftohen rezultate më të mira lyerjeje pas tharjes së ngjitësit. Shënim: sistemet jofleksibël të lyerjes mund të dëmtojnë elasticitetin e ngjitësit dhe të shkaktojnë plasaritje në shtresën e bojës.
- Mund të ndodhin ndryshime të ngjyrës për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta dhe/ose rrezatimit UV (sidomos në ngjyrën e bardhë). Ky efekt është estetik dhe nuk ndikon negativisht në performancën teknike apo në qëndrueshmërinë e produktit.
- Përdorni gjithmonë Sikaflex®-111 Stick & Seal në kombinim me fiksues mekanikë për aplikimet tavanore ose për elementë të rëndë.
- Për elementet e rënda, vendosni suport të përkohshëm derisa Sikaflex®-111 Stick & Seal të jetë tharë plotësisht.

- Nuk rekomandohen aplikimet / fiksime të gjithë sipërfaqes pasi pjesa e brendshme e ngjitësit mund të mos thahet kurrë.
- Përpara përdorimit mbi gurin natyror, kontaktoni me shërbimin teknik.
- Të mos përdoret mbi gomë natyrore, gomë EPDM ose mbi material ndërtimi prej të cilit mund të rrjedhin vajra, plastifikues ose tretës të cilët mund të dëmtojnë ngjitësin.
- Për përdorim mbi nënshtresa bituminoze, rekomandohet kryerja e testeve paraprake ose kontaktoni me shërbimin teknik.
- Të mos përdoret mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon) dhe disa materiale sintetike të plastifikuara. Rekomandohet kryerja e testeve paraprake ose kontaktoni me shërbimin teknik.
- Të mos përdoret për izolimin e fugave brenda dhe përreth pishinave.
- Të mos përdoret për fugat në presion uji apo në zhytje të përhershme në ujë.
- Të mos përdoret për izolim qelqi, në dysheme dhe për fugat në pajisjet hidrosanitare.
- Të mos përdoret për ngjitje qelqi nëse vija e ngjitjes do të ekspozohet në rrezatim diellor.
- Të mos përdoret për ngjitje strukturore. Mos ekspozoni Sikaflex®-111 Stick & Seal e patharë ndaj produkteve me përmbajtje alkooli, pasi mund të ndikojnë në reaksionin e tharjes.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikaflex®-111 Stick & Seal
Qershor 2020, Botimi 06.01
02051302000000053

Sikaflex-111StickSeal-sq-AL-(06-2020)-6-1.pdf